




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-1831/20
Dep. DPKI	Bi Prot. 06-1831/20
Nr. i faq. 03	Prot. No. 06-1831/20
Broj stranica 03	Data 08-09-2020
Nr. pages 03	Datum 08-09-2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-1181/20*, për zyrtaren e lartë znj. Alberta Troni, Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prishtinës "Hasan Prishtina", për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPK-06-1181/20*, që për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë znj. Alberta Troni, Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prishtinës "Hasan Prishtina", është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet, sipas detyrës zyrtare pas kontrollit ku është identifikuar se zyrtarja e lartë, respektivisht Anëtarja e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prishtinës "Hasan Prishtina" figuron të jetë Drejtor dhe person i Autorizuar në Organizatën Joqeveritare "PRISHTINA SUMMER FESTIVAL".

Sipas procedurës Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, që të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e informacioneve dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. *DPKI-06-776/20*), rezultoi se zyrtarja e lartë znj. Alberta Troni, është drejtor dhe person i autorizuar në Organizatën Joqeveritare "PRISHTINA SUMMER FESTIVAL" me nr. regjistrimi .

Pas konfirmimit të informacionit nga ana e Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, në pajtim me nenin 22,paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit nr.06/L-011,Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1311/20, e ka njoftuar zyrtaren lartë znj.Alberta Troni, Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina” për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja e lartë znj.Alberta Troni, ka treguar interesim duke kontaktuar zyrtaret e AKK-së, të cilët sipas procedurës e kanë informuar atë për iniciimin e rastit dhe për obligimet ligjore, ku zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mundet që njëkohësisht të ushtrij funksion drejtues dhe as të jetë Përfaqësues i Autorizuar në Organizata Joqeveritare, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, siç e përcaktohet me nenin 13 paragrafi 1,të Ligjit nr.06/L-011,ku thuhet se :

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

si dhe nenin paragrafi 1, i cili përcakton se :

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to”.

Pas kësaj procedure të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtarja e lartë znj.Alberta Troni, është pajtuar me gjetjet dhe faktet e paraqitura të Agjencisë, duke njoftuar se do të ndërmer veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga sistemi i Departamentit për OJQ-, me të cilën dëshkohet se znj.Alberta Troni, nuk figuron me si drejtor dhe person i autorizuar në Organizatën Joqeveritare PRISHTINA SUMMER FESTIVAL”.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë znj.Alberta Troni, Anëtare e Këshillit Drejtues, të Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina”, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik përkatësisht konfliktit të interesit, andaj, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

